



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:026455

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06880373

**C-IV-14-3263**

*Ankuesi:*

**Sh Sh** nga Mitrovica.

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Lux”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt. 03 shkurt 2025, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. MIT0390336 i dt. 23 prill 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**2. Ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt. 28 prill 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. MIT0390336 i dt. 23 prill 2014, me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për dëshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 420.00 euro. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se ankesën e paraqet për shkelje të prezumimeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale. Duke shtuar se i njëjti ka qene punëtor i NSH-së deri në muajin Mars 2004, me saktësisht deri në privatizimin e “Shtëpisë së Mallrave”, pronën e parë të privatizuar të NSH-së, dhe se i njëjti ka qene përfitues i 20%.

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me dt.17 janar 2025, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit duke shtuar se objekti i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Parashtruesi nuk ka theksuar se cilin nen e ka shkelur AL në marrjen e vendimit e rrjedhimisht vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se ankesa është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Andaj ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata me datë 13 nëntor 2024, ka lëshuar urdhër që ankuesi në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të parashtrorj prova shtese, më saktësisht kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrdhënjes së punës me emër dhe mbiemër të ankuesit, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës së pagave si dhe prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Nga fletkthesa për dorëzim personal shihet se ankuesi të njëjtin urrdhër e ka pranuar me datë 02 dhjetor 2024, mirëpo të njëjtit nuk i është përgjigjur edhe pse i njëjti me urrdhërin e lëshuar është njoftuar për pasojat e mos përgjigjes së të njëjtit.

Me 17 janar 2025, e paditura AKP ka parashtruar pwr gjigjen nw ankesw me tw cilwn thekson se Agjencia si pwrfaqwsuese ligjore e tw paditurws i kundwrshton tw gjitha pretendimet e paditwsit tw paraqitura nw padinw e tij duke i konsideruar si tw pa bazuara nw ligj dhe si e tillw duhet tw refuzohet. Mw tutje nw mbrojtjen e AKP-sw theksohet se kwresa e paditwsit per kompensimin e shumws financiare ishte refuzuar pwr arsye se paditwsi nuk kishte ofruar shwrbime pune pwr NSh-nw nga 19 janari 2004, pwr mw tepwr parashtruesi nuk figuron as nw listwn e pagave nga data e lartcekur.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e

tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Prandaj, shihet se parashkrimi për dëmshpërblimin e shkaktuar për shkak të shkëputjes së marrdhënjes së punës në këtë lëndë ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që të dëshmojë se i takon dëmshpërblimi për ndërprerjen e parakohshme të marrdhënjes së punës në shumë prej 420.00 euro. Ankuesi së bashku me ankesë ka dorëzuar kopjen e vendimit të kundërshtuar. Ankuesi as pas pranimit të urrdhërit për deponim të provave që mbështesin ankesën, të njëjtat nuk i ka deponuar, andaj gjykata vije në përfundimin se ankuesi dështoj që të dorëzonte prova në mbështetje të pretendimeve ankimore për të dëshmuar se e i njëjti në kohën e daljes së NSH-së në likuidim ka qene ne marrdhënje pune dhe se ka pranuar paga nga e njëjta, pasi i njëjti me asnjë provë para gjykatës nuk ka arritur që ti dëshmoj pretendimet e tij ankimore.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. I njëjti do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se të njëjtit i është ndërpre marrdhënja e punës me daljen e NSH në procedurë të likuidimit, dëshmi se i njëjti ka pranuar pagë nga NSH-ja, si dhe librezën e punës me të cilën do të dëshmohej se i njëjti ka ofruar shërbime për NSH-në.

Andaj, me qene se i njëjti nuk i ka ofruar provat e nevojshme për të vërtetuar pretendimet e tij ankimore as pas pranimit të urrdhërit të gjykatës për deponimin e të njëjtave si dhe pas paralajmërimit për pasojat e mos pranimit të të njëjtit, gjykata në mungese të provave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i refuzuar pretendimet e ankuesit si të pa bazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13 par.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që vlera e kontestit është nën 1.000€.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a  
**Hajrie Shala**